



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:103957

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06185571

KPPP.nr. 559/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ideal Group” Sh.P.K., me seli në Pejë, rr. “Kreshnik Ademaj”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shqiponjë Beqiraj, avokate nga Peja, kundër debitorit N.T.P “Pashtriku”, me numër unik identifikues 810309923 dhe seli në Klinë, rr. “Hoxhë Kadri Prishtina”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 194/23, të datës 13.03.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku nga Peja, jashtë seancës me datën 20.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.P “Pashtriku”, ashtu që ANULOHET Urdhri përmbartimor P.nr. 194/23 i datës 13.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Ideal Group” Sh.P.K., me datë 13.03.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 194/23 duke lejuar përmbartimin ndaj debitorit N.T.P “Pashtriku”, me seli në Klinë, dhe atë mbi bazën e dokumenteve: Faturë nr. 1540, e datës 20.06.2019; Faturë nr. 3244, e datës 21.11.2018; Faturë nr. 3240, e datës 21.11.2018; Faturë nr. 2948, e datës 22.10.2018; Faturë nr. 2940, e datës 20.10.2018; Faturë nr. 2744, e datës 29.09.2018; Faturë nr.2743, e datës 29.09.2018; Faturë nr. 2422, e datës 28.08.2018; Faturë nr. 1836, e datës 27.06.2018; Faturë nr. 1835, e datës 27.06.2018; Faturë nr. 1129, e datës 23.04.2018; Faturë nr. 249, e datës 31.01.2018; Faturë nr. 248, e datës 31.01.2018; Faturë nr. 186, e datës 25.01.2017; Faturë nr. 3225, e datës 28.12.2017; Faturë nr. 3216, e datës 27.12.2017;

Faturë nr. 898, e datës 31.03.2018, ashtu që është urdhëruar debitori, që në afat prej 7 ditësh në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 8,655.00 EUR (tetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë euro) me kamatë ligjore prej 8 % nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrit Përmbarimor, me arsyetimin se faturat të cilat janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, janë paguar me kohë, ndërsa faturat e tjera janë me numër dhe datë të njëjtë, mirëpo me shumë të ndryshuar të vlerës së faturës, ashtu që edhe nënshkrimi në të njëjtat fatura është i falsifikuar. Ka shtuar se faturat nuk paraqesin dokument të besueshëm si dhe të njëjtat janë të parashkruara, andaj edhe nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e urdhit për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri për përmbarim të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për ushtrimin e prapësimin në shumë prej 208.00 EUR.

Kreditori, përmes përfaqësueses së autorizuar në përgjigjen në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm pasi që debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datë 22.03.2023, ndërsa prapësimin e ka dorëzuar në gjykatë me datë 29.03.2023, ndërsa gjykata përmes njoftimit prapësimin e ka dërguar tek Përmbaruesi me datë 14.04.2023, ashtu që i njëjti është dorëzuar pas më tepër se 20 ditësh nga data e pranimit të urdhit, duke i propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta hudhë poshtë si të pasafatshëm. Më tej, ka theksuar se është lejuar përmbarimi në bazë të dokumentit të besueshëm, faturave të cilat janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, dhe si të tilla kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe janë të përshtatshme për përmbarim bazuar në nenin 29 të LPP-së. Nga të lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi, si dhe ka kërkuar shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 104.00 EUR.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata fillimisht shqyrtoi pretendimin e kreditorit se prapësimi i debitorit është paraqitur jashtë afatit ligjor ashtu që nga shkresat e lëndës, saktësisht nga fletë kthesa për dorëzim personal gjeti se urdhri për përbarim P.nr. 194/23 është pranuar nga debitori me datë 22.03.2023, ndërsa prapësimi është ushtruar nga debitori në direkt për në Gjykatën Themelore në Klinë me datë 29.03.2023, brenda afatit shtatë (7) ditor nga data e pranimit të urdhrit, fakt këtë të cilin e vërteton edhe shënimi zyrtar i lëshuar nga Përmbauesi Privat me datë 14.04.2023.

Në këtë drejtim, fakti se prapësimi i debitorit ka arritur pranë Përmbauesit Privat me datë 14.04.2023, nuk e bën prapësimin e debitorit si të pasafatshëm, kjo për faktin se dorëzimi i prapësimin nga debitori direkt për në Gjykatën Themelore në Klinë, paraqet gabim të hapur nga debitori si parashtrues, kjo meqenëse kompetente për vendosje të prapësimin në kohën e ushtrimit të tij ka qenë pikërisht kjo gjykatë. Andaj gjykata, në mbështetje të nenit 128 të LPK-së i cili përcakton se *“Në qoftë se parashtrësja që lidhet me afat i është dorëzuar apo dërguar gjykatës jo kompetente brenda afatit, kurse në gjykatën kompetente arrin pas skadimit të afatit, do të konsiderohet se është ruajtur afati po që se paraqitja e saj në gjykatën jo kompetente mund t’i vishet padijenisë apo gabimit të hapur të parashtruesit”*, si datë të dorëzimit të prapësimin të debitorit ka marrë datën e dorëzimit pranë Gjykatës Themelore në Klinë më 29.03.2023, datë kjo brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita e pranimit të urdhrit përbarimor.

Meqenëse prapësimi i debitorit është paraqitur brenda afatit ligjor, Gjykata, ka shqyrtuar pretendimet e debitorit në raport me parashkrimin e kërkesës së kreditorit dhe gjeti se borxhi që derivon nga faturat objekt i këtij përbarimi ka arritur afatin e parashkrimit për arsyet si në vijim:

Gjykata fillimisht konstatoi se faturat objekt i këtij përbarimi janë lëshuar për periudhën kohore nga data 27.12.2017 e deri më datë 20.06.2019, , fakt ky që vërtetohet edhe nga kartela e klientit e ofruar nga kreditori në propozimin për përbarim. Në anën tjetër, propozimi për përbarim në raport me faturat objekt i këtij përbarimi është paraqitur me datë 13.03.2023.

Andaj, në mbështetje të nenin 355, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili përcakton se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*, rezulton se borxhi objekt i këtij përbarimi është përfshirë në parashkrim, pasi që nga arritja për pagesë e

faturës së fundit 1540 të datës 20.06.2019, e deri në inicimin e propozimit për përmba rim, kanë kaluar mbi tre (3) vite.

Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së, i cili përcakton se: “...*prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmba rues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve*”.

Ndërsa vendimin mbi përfundimin e procedurës përmba rimore Gjykata e mbështeti në nenin 66.3 të LPP-së i cili përcakton se “*Përmba rimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmba rim*”.

Pretendimet e kreditorit se debitori ka bërë pagesa të pjesshme të paspecifikuara, e rrjedhimisht ka ndërprerë afatin e parashkrimit në raport me borxhin e kërkuar, gjykata i vlerësoi si të paqëndrueshme. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që nga kartela e klientit e ofruar nga vet kreditori me propozimin për përmba rim, rezulton se pagesa e fundit e debitorit është bërë me datë 20.06.2019, andaj edhe sikur kjo pagesë të llogaritet si pohim i tërësishëm i borxhit nga debitori, prapëseprapë, afati i parashkrimit ka rifilluar ditën e nesërme pas kësaj pagese, pra me datë 21.06.2019, kjo në mbështetje të nenit 373 par.3 të LMD-së i cili parasheh se “*Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi) meqenëse afati i parashkrimit të borxhit të debitorit*”

Kësisoj, meqenëse edhe nga data e pagesës së fundit të debitorit, e deri në inicimin e propozimit për përmba rim me datë 13.03.2023 përsëri kanë kaluar mbi tre (3) vite, gjykata gjen se borxhi sipas faturave objekt i këtij përmba rimi, përsëri ka arritur afatin e parashkrimit nga neni 355 i LMD-së.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 dhe 73 të LPP-së, nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmba rimore, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 559/24, datë 20.09.2024

Numri i lëndës: 2023:103957
Datë: 20.09.2024
Numri i dokumentit: 06185571

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.